



Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe në bazë të kërkesës për inicim te procedurës disiplinore nga Komisioni i Garave, Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 05.12.2022 merr këtë:

## VENDIM

### I. SHQIPTOHET pezullimi i Lindrit Misinit (zyrtar i KB Trepça)

## ARSYETIM

Me datë 30.11.2022, Komisioni Disiplinor (KD), përmes postës elektronike nga Sekretarja e FBK-së, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore lidhur me incidentin në ndeshjen mes KB Trepça dhe KB Peja, xhiroja XII e Prince Caffè Superligës së Kosovës (edicioni 2022/23).

Incidenti në fjalë ka të bëjë me trazirat gjatë ndeshjes së cekur, ku supozohet se, gjatë hyrjes në zhveshtore, është goditur në tunel Arbër Elshani (anëtar i kryesisë KB Peja) nga Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës).

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 05.12.2022. Para takimit, Sekretarja e Përgjithshme e FBK është autorizuar nga KD për të kërkuar deklaratat nga akterët e përfshirë në këtë rast. Këta të fundit kanë dërguar deklaratat nga personat a përfshirë, përkatësisht nga Arbër Elshani (Drejtor Gjeneral i KB Peja) dhe Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës).

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar deklaratat në dispozicion dhe ka ardhur në përfundim se provat nuk mjaftojnë për të marrë vendim përfundimtar. Si rrejdhojë, në bazë të nenit 39 të Rregullores Disiplinore, deri në marrjen e vendimit final, Lindrit Misinit i shqiptohet pezullimi 7 ditë nga pozita e tij si zyrtar i paraqitur në dokumentacionin e KB Trepça në FBK.

  
Omer Daku  
Kryetar i Komisionit Disiplinor



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

